



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 10.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Mergime Kajtazi – KDI, Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office, Floriana Merovci, ZPRK, Alban Bujari – Koha Ditore, Kenan Gashi – Avonet dhe Lumturie Beka – Kosova Indo.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3.08 dhe 10.09.2015;
3. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3.08 dhe 10.09.2015

Armend Zemaj kërkoi që në procesverbalin e datës 10.9.2015, në faqen e tretë të fshihen fjalët “Kërkoi së pari që të flitet për pikat e rendit të ditës, përndryshe nuk do vazhdojnë mbledhjen.”

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 3.08 dhe 10.09.2015, me vërejtjen e deputetit Armend Zemaj.

3. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi

Kryesuesja e njoftoi komisionin se grupi punues të cilin e ka kryesuar ka mbajtur takim dhe ka përgatitur draftin e konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në pajtim me nenin 5 A të ligjit nr. 05/L -033, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, obligohemi që të shpallim konkurs për plotësimin e këtyre pozitave. Më tutje tha se për anëtarin nga Oda e Avokatëve të Kosovës, kemi vlerësuar se kandidati, përveç kushteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë edhe kushtet:

Të ketë ushtruar funksionin e avokatit në Republikën e Kosovës për së paku 3 (tre) vjet;

Të ketë integritet të lartë moral;

Të mos jetë i dënuar për vepër penale në Kosovë;

Të mos ketë ushtruar ndonjë funksion politik në 3 (tri) vjetët e fundit.

Kurse për kandidatin nga komuniteti serb janë të njëjtat kushte që përmenda më lart, përveç se kandidati që nuk ushtron funksionin e gjyqtarit, duhet të ketë përvojë pune së paku 10 (dhjetë) vjet në Kosovë dhe duhet të ketë njohuri për funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Armend Zemaj tha se si grup kemi punuar mbi bazën e ligjit të ri që na obligon të hapim konkursin. Tani ju e keni draftin e propozuar dhe vlerësoj se si i tillë mund të procedohet për publikim.

Agim Aliu tha se pavarësisht faktit që është vonuar kjo procedurë dhe është për t'u përshëndetur pasi që për herë të parë kemi përcaktuar formën e konkursit, përkundër asaj që kemi pasur një debat të gjerë se cila do të jetë forma dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së. Kjo për faktin se për 15 vjet e kemi kritikuar mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe tani më e kemi normuar me ligjin e ri dhe kjo punë e grupit është në harmoni me ligjin dhe si e tillë mund dhe duhet të procedohet për publikim.

Milena Miliqeviq duke ju referuar nenit 108, paragrafit 6, pika 3 e Kushtetutës kërkoi sqarim lidhur me zgjedhjen e anëtarit nga komuniteti serb, se a mundet që edhe anëtari i dytë nga ky komunitet të jetë gjyqtar?

Armend Zemaj duke u ndërlidhur me parafolësen tha se neni 108. paragrafi 6, pika 3 e Kushtetutës thotë që “së paku njëri nga anëtarët duhet të jetë gjyqtar”. Pra nuk e ndalon që të dy mund të jenë gjyqtarë. Por nëse kandidati nuk është gjyqtar atëherë ai duhet t'i ketë së paku 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në Kosovë dhe duhet të ketë njohuri për funksionimin e sistemit

gjyqësor të Republikës së Kosovës. Pra, për kandidatet që nuk vijnë nga fusha e gjyqësorit ka një standard tjetër dhe kërkohet t'i ketë 10 vjet përvojë pune.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Vendim

- I. Të shpallet Konkursi për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- II. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.
- III. Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit që është miratuar në Komision.

4. Të ndryshme

Kryesuesja tha se grupi punues që e kam kryesuar në lidhje me nismën për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ka mbajtur disa takime me përfaqësues nga Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese, Ministria e Drejtësisë dhe me ish- gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Pas këtyre takimeve dhe marrjes së argumenteve nga secila palë kemi vlerësuar se nuk ka arsye të mjaftueshme që të bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Sipas ekspertëve që i kemi pasur në takim është vlerësuar se ky kufizim kohor nuk paraqet pengës për kontestimin e akteve ligjore në Gjykatën Kushtetuese për faktin se kushtetuta jonë njeh edhe të drejtën e palëve për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Më tutje tha se kemi edhe një njoftim nga Gjykata Kushtetuese se është formuar një grup punues i brendshëm që po e analizon ligjin aktual dhe nevojën për ndryshim. Andaj, tani për tani pushon aktiviteti i grupit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Armend Zemaj tha se është mirë që keni pushuar aktivitetet për këtë nismë për faktin se edhe në fillim kam qenë kundër kësaj nisme për arsye se disa institucione që janë kategori kushtetuese nuk janë pjesë e dëshirave individuale, sepse janë pushtete të ndara dhe të pavarura. Andaj propozime të tilla duhet të kthehen dhe nuk duhet të bëhen pjesë e politikës dhe nuk duhet të hapim beteja në mes të institucioneve për diçka që është pjesë e punës së tyre duke pretenduar që një institucion të jetë më superior se tjetri. Ai e njoftoi komisionin se Nënkomisioni ka filluar të merret me ligjin për Kuvendin dhe rregulloren e punës. Për Projektligjin për Kuvendin kemi vendosur që të mbajmë një takim me kryetarin e Kuvendit lidhur me vendimin e kryesisë që i ka adresuar Komisionit dhe nëse është e nevojshme edhe me shefat e grupeve parlamentare. Kjo na duhet që orientohe mi se si do të punojmë në mënyrë që mos të hupim kohë të panevojshme në hartim nëse nuk ka vullnet. Po ashtu kemi vendosur që të fillojmë draftimin e rregullores së punës së Kuvendit. Siç e dini ne e kemi një draft nga legjislatura e kaluar e cila e pat marrë votën në parim dhe nuk ishte proceduar asnjëherë për lexim të dytë për arsyet tashmë të njohura. Lidhur me këtë lus anëtarët e komisionit që jenë pjesë e këtyre ndryshimeve, pasi nesër në orën 13 do ta mbajmë një punëtori të Nënkomisionit ku do të fillojmë të punojmë mbi draftin e rregullores së mbetur në procedurë nga legjislatura e kaluar, sepse është një draft shumë më i

avancuar se kjo rregullore që kemi në fuqi. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit që ta analizoni këtë draft dhe në takime të vini me propozime konkrete në mënyrë që mos të humbim kohë.

Agim Aliu e njoftoi Komisionin me aktivitetin e grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ai tha se si grup e kemi përfunduar punën, kemi bërë disa amendamente dhe, nëse akordoheni si komision, ato të jenë në rend dite në takimin e radhës së Komisionit.

Në fund Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më 17.11.2015, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi